

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN ME MJEDISIN TË PROJEKTIT

Shoqeria "HYMAR GROUP" sh.p.k.

Aktiviteti: "Mbareshtim intensiv i zogjve per mish dhe thertore"

Rruga Korçe-Voskop, Km. i 3, zona kadastale 1816, nr.pasurie 156/68, 156/69.

Ky informacion u hartua sipas VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore"

**RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN E
“RRITJE INTENSIVE E SHPENDEVE NE NJE INSTALIM,
THERTORE”**

PRONE E SHOQERISE “HYMAR GROUP” SHPK,

Korçe, Voskop, Rruga Korçe-Voskop, Km-3 te

BASHKIA KORÇE

Sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, pika 17/a-instalime per mbareshtimin intensiv te pulave me a)mbi 1000 krere per pulat qe rriten per mish , 20000 vende per pulat qe rriten per veze



Subjekti

Shoqëria : “HYMAR GROUP” SH.P. K

Bashkia Korçe

Studio “ADDON”

Eksperte Mjedisore

Ing. Yzet Miraka



PERMBAJTJA E LENDES

1.2 Raporti paraprak i VNM-se.....

- a. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi.....
- b. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij.....
- c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundëshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.....
- ç. Një përshkrim për shkarkimet e mundëshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe përdorimi i mbetjeve. Shkarkimet e mundëshme në mjedis si ujra të ndotur, gazra, pluhra, zhurma, vibrime, prodhimi i mbetjeve.....
- d. Informacion për kohëzgjatjen e mundëshme të ndikimeve negative të identifikuara
- dh. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapsinore të ndikimeve negative në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.....
- e. Mundësitë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.....
- ë. Masat e mundëshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.....
- f. Ndikimet e mundëshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).....

HYRJE

Qellimi i projektit është venia në funksion e një kompleksi për rritjen e shpendeve për mish, i ndodhur në fshatin Goskove-Posht, Voskop . Ky aktivitet do të kryhet nga Subjekti "HYMAR GROUP" SH.P.K., me NUIS/NIPT L64025002F, me seli fshatin Goskove Posht, Njësia Administrative Voskop, Bashkia Korce, dhe përfaqësues ligjor Marenglen MYRTOLLARI. Ndertimi dhe funksionimi do të jetë me qëllimin e vetëm të rritjes intensive të shpendeve për mish dhe ndërtim ambjente ndihmese si thertore, magazine frigoriferike, zyra shërbimi, etj.


1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Terreni është kryesisht me reliev të sheshtë. Zona ndodhet 100 m larg rrugës Korce Voskop , dhe në të gjithë anët kufizohet me tokë bujqësore. Kjo sipërfaqe tokë e vënë në dispozicion të këtij aktiviteti, është një tokë bujqësore, pjesë e fushës së Voskopit, Korce. Distanca nga qendrat e banuara dhe burimet ujore të zonës në studim janë 1 km dhe 50m larg perroit të Drevnices. Bimesia e kësaj zone përbehet kryesisht nga kulturat bujqësore të zonës, si dhe pjesërisht nga bimësi shkurre në terrenet kodrinore të zonës përreth.

Në këtë zonë të vlerësimit, tokat bujqësore janë të kultivuara në mënyrë sistematike nga banorët e zonës, pasi janë mjaft produktive dhe të pasura me burime ujore.

Pamje satelitore e zonës dhe bimesisë





Koordinatat e pikave te rrethimit te objektit

| Pika | X | Y |
|------|------------|------------|
| 1 | 4477586.20 | 4498517.63 |
| 2 | 4477564.45 | 4498458.69 |
| 3 | 4477767.18 | 4498399.07 |
| 4 | 4477781.44 | 4498460.07 |

Pershkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN.

Ne lidhje me projektin

Nga verifikimet paraprake, rezulton se ky projekt nuk ndodhet ne zone te mbrojtur. Zona e mbrojtur me e afert eshte ajo e "Parkut Kombetar te Butrintit", ne jugperendim, e cila ndodhet rreth 4.3km ne vije ajrore.

Pershkrimi i zonave të mbrojtura përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive.

Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës

Monumentet Natyrore te Rrethit Korçe(Sipas VKM 676)

| Nr. | Monumenti Natyror | Nr. | Monumenti Natyror |
|-----|-------------------------------|-----|------------------------------|
| 1 | Guri i Prere | 15 | Pisha e Shendellise |
| 2 | Guri i Capit | 16 | Rrepet e qytetit (Shenmeria) |
| 3 | Piramidat e Tokes se Zhombrit | 17 | Shparthi i Osojes-Bakullit |
| 4 | Bokerimat e Moglices | 18 | Pisha e Voskopoje |
| 5 | Ishulli i Malligradit | 19 | Pisha e Makrezes |

| | | | |
|----|---|----|--|
| 6 | Vareze fosilesh te kretes se poshteme (Lavdar) | 20 | Bredhi i burimit te Çardakut (Gurit i Capit) |
| 7 | Mosperpathje kendore e Polenes se Vjeter | 21 | Ahishtja e Protopapes Opar |
| 8 | Burim uji dhe gazi te djegshem ne thyerjen tektonike te Polenes | 22 | Bliri i Shen Pjetrit (Vithkuq) |
| 9 | Liqenet e Lenies | 23 | Plepi i Gjyrasit |
| 10 | Lisat e Shenthanasit | 24 | Pylli i perzjere i Maliqit |
| 11 | Rrobulli i Kuq | 25 | Ahishtet e Bofnjes |
| 12 | Zgavra e Zaverit (Prespe) | 26 | Venjat e Kallamasit |
| 13 | Dushqet e Manastirit (Djellas Prespe) | 27 | Rrobulli i Lenies |
| 14 | Venjat e Dishnices | | |

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



Monumentet e kulturës që mund të vizitohen në rrethin e Korçës janë:

- Kalaja e Mborjes në fshatin Mborje e ndërtuar mbi një kodër të lartë në afërsi të qytetit.
- Kalaja e Klocës në fshatin Klocë.
- Kalaja e Koçaçit në fshatin Koçaç.
- Kalaja e Symizës në fshatin Symizë.
- Kalaja në fshatin Podgori.

- Kalaja në fshatin Dishnicë.
- Kalaja në fshatin Kuç i Zi.
- Kalaja e Gobeshit në fshatin Moglicë.
- Kalaja e Gradishtës në fshatin Zerec.
- Vendbanimi prehistorik gjatë rrugës automobilistike në fshatin Vashtëmi.
- **Vendbanimi prehistorik në qytetin e Maliqit etj.**

Në qarkun e Korçës ka dhe mjaft objekti kulti të vizitueshme si:

- Manastiri i Shën Pjetrit dhe Kisha e Shën Kozmait (Qimitiri) në fshatin Vithkuq.
- Manastiri i Shën Prodhromit në fshatin Voskopojë.
- Kisha e Manastirit të Shën Marisë në fshatin Lubonjë.
- Kisha e Shën Thanasit në fshatin Voskopojë ka piktura te shek 18 te bera nga Kostandini i Beratit.
- Kisha e Shën Mëhillit në fshatin Voskopojë.
- **Kisha e Shën Kollit në fshatin Voskopojë.**
- Kisha e Shën Marisë në fshatin Voskopojë.
- Kisha e Shën Jovanit në fshatin Bobshticë mendohet te jet ndertuar ne shek e 13.
- Kisha e shën Mitrit në fshatin Bobshticë u ndertua dhe u pikturua ne shek e 17.
- Kisha e Ristozit në fshatin Mborje ka portretin e Jezuit duke hyr ne Jeruzalem. Mbishkrimet tregojnë se kisha ka qenë egzistente në 1389 dhe shumë gjëra tregojnë se është ndërtuar në 1300. m

.Xhamia e Iliaz Mirahorit në qytetin e korçës.

- Hani "Elbasani" në qytetin e Korçës.
- Hani "Manastiri" në qytetin e Korçës.
- Pazari i Vjetër i qytetit të Korçës.
- Katedralja e Shën Marisë (Muzeu Antik Mesjetar).
- Misafirhaja e Vangjush Mihos (studio) Rr. Shpresa Palla" Nr. 12 qyteti i Korçës.
- Shtëpia ku u ngrit Flamuri i Republikës së Korçës (Muzeu Historik).
- **Mësonjtorja** e parë shqipe në qytetin e Korçës (Muzeu i Arsimit Kombëtar).
- Shtëpia ku u krijua qarkor i partisë në qytetin e Korçës.
- Shtëpia e Themistokli Gërmenjit në qytetin e Korçës.
- Shtëpia e Mihal Gramenos në qytetin e Korçës.
- Shkolla e vjetër në fshatin Panarit ku më 1944 u përgatitën kuadrot e para të PPK.
- Shkolla në fshatin Kucakë ku ka qendruar Shtabi i Përgjithshëm dhe E. Hoxha.
- Shtëpia ku ka ndenjor shtabi i përgjithshëm në fshatin Vithkuq
- Monumenti i luftëtarit kombëtar në qytetin e Korçës.
- Monumenti i Themistokli Gërmenjit.
- **Tuma e Kamenicës**

Gjithashtu gjenden edhe shumë monumente natyre, shumë të bukura për t'u vizituar.



Pamje nga Ishulli i Maligradit

- Guri i Capit
- Piramidat e Tokës së Zhombrit
- Bokerimat e Moglicës
- Ishulli i Maligradit
- Varrezë fosilesh të kretes së poshtëme (Lavdar)
- Burim uji dhe gazi të djegshëm në thyerjen tektonike të Polenës
- Liqenet e Lenies
- Lisat e Shënthanasit
- Rrobulli i Kuq
- Zgavra e Zaverit (Prespë)
- **Dushqet e Manastirit** (Djellas, Prespe).
- Venjat e Dishnicës
- Pisha e Shendellise
- Rrepet e qytetit (Shënmëria)
- Shparthi i Osojes-Bakullit
- Pisha e Voskopojës
- Pisha e Makrezes
- Bredhi i Burimit të Çardakut (Guri i Capit)
- Ahishtja e Protopapes Opar
- Bliri i Shën Pjetrit (Vithkuq)
- Plepi i Gjyrasit
- Ahishtet e Bofnjes
- Venjat e Kallamisit e tjerë.

Në këtë rreth, duke u mbështetur në kriteret e Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës (IUCN), janë shpallur edhe këto zona të mbrojtura si parqe kombëtare.

- **Bredhi i Drenovës** me sip. 1,380.0 ha, zonë e mbrojtur e kategorisë së II me VKM nr. 96, datë 21.11.1966
- **Prespa** me sip. 27,750.0 ha, zonë e mbrojtur e kategorisë së II me VKM nr. 80, datë 18.02.1999.

· **Krastafillak** – Pylli i përzejere i Maliqit me sip.250.0 ha, zonë e mbrojtur e kategorisë së IV me Urdhër MB, 1970

2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Zona është me relief fushor dhe nuk ndodhet në afërsi të burimeve ujore të rëndësishme si, Liqene, Rezervuare apo Zona Bregdetare me përjashtim të lumit, pra nuk ka burime ujore të rëndësishme të identifikuara. Distanca nga qendrat e banuara dhe burimet ujore të zonës në studim janë 1 km dhe 50m larg perroit të Drevnices. Pranë aktivitetit ndodhen disa rezervuare të vegjël të cilat janë krijuar vetë nga banoret e zonës për qëllim ujëjitje. Këto rezervuare ndodhen në një distancë të largët nga aktiviteti.



3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Mjedisi është gjithmone i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtëpërdrejtë, të terthorë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm. Një nga objektivat e këtij njoftimi për fillimin e procedurës së thelluar të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ndërtimi dhe zhvillimi i këtij aktiviteti në teresi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të instalimit për rritjen intensive të shpendeve. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky projekt do të vazhdojë të jetë i tillë edhe pas shumë kohësh. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te detajuar ne raportin e thelluar te VNM-se, pas sygjerrimeve nga AKM-ja dhe Ministria e Mjedisit per projektin qe kerkohet te zhvillohet. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikoohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

- **Impakti ne mjedis i ketij projekti dhe menaxhimi i tij**

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me ndertimin e projekt – idese dhe funksionimit te instalimit per rritjen e shpendeve gjate fazes operative se bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Çeshtjet e mjedisit te lidhura me magazinimin lendes se pare ushqimore dhe instalimit te shpendeve ne llogjiken e ciklit te jetes se produktit perfshijne:

- Praktikate qendrueshme: Impakti me i madh mjedisor ne rritjen e shpendeve per tregtim konsiston ne menaxhimin e burimeve .

- Praktika te qendrueshme ne menaxhimin e lendeve te para dhe perdorimin sa me eficient te saj gjate procesit te ndertimit dhe gjate procesit te rritjes se shpendeve, duke ndikuar pozitivisht ne rritjen e shendetshme te shpendeve.

Praktika te qendrueshme ne reduktimin e emetimeve ne ajer nga proceset e ndertimit te kompleksit I kat dhe gjate fazes operative per pastrimin e mbetjeve organike, perdorimin e filtrave per kapjen e karbonit total dhe ventilatoreve per eliminimin e aromave te pakendshme gjate procesit te pastrimit dhe dezinfektimit te lokaleve te shpendeve.

- **Shkarkimet ne ujera**

Gjate fazes se ndertimit te objektit:

Ne fazen e ndertimit kemi perdorim te volumeve te vogla te ujit. Uji do te perdoret kryesisht per lagjen e sheshit te ndertimit dhe stabilimentit. Sasia e ujit te perdorur do te jete ne mase te tille qe nuk do te ndikojne ne rritjen e turbulidedit te ujrave siperfaqesore te zones.

Gjate fazes se funksionimit te instalimit:

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) Pastrimi i ambjentit ne rastin e pergatitjes per instalimin e radhes
- b) Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambjentin e objektit.
- c) Ujrat e gjeneruara nga mbetjet e plehut organik, si pasoje e dekompozimit natyral te tyre
- d) Ujrat e perdorura per qellime sanitare.

Lidhur me ujerat qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk do te perzihen me ujrat teknologjike, por do te kalojne ne sistem kanalizimi dhe te lidhen me kolektorin e zones.

Gjithashtu ujerat teknologjike, pas proceseve te ndarjes ne dekantor do te kalojne ne sistem te mbyllur me riqarkullim, ose pas dekantimit te tyre nga lenda e ngurte ne pezulli, do te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Ne asnje rast nuk shkarkohen ne mjediset ujore siperfaqesore, ne gjendjen fillestare te tyre, pa kaluar ne sistem trajtimi fizik.

Duke marre ne konsiderate respektimin e kushteve teknike ne kete objekt, mundesite e ndotjes nga rastet e emergjencave jane te rralla. Ujrat e pastrimit te ambjentit dhe mbetjeve ose produktit do te trajtohen ne vasken e dekantimit paraprakisht para se te shkarkohen ne rretin e kanalizimeve. Ne asnje rast nuk do te shkarkohen ne mjedisin ujor te zones pa u trajtuar paraprakisht.

Ndikimi i ketij aktiviteti ne ujera gjate fazes se funksionimit do te konsistoje ne ujerat e pastrimit te ambjentit te punes.

- **Ndotja e tokes**

Gjate fazes se ndertimit te objektit

Ne fazen e ndertimit te objektit nuk kemi kontaminim te tokes me lende te rrezikshme, pasi ne asnje rast nuk do te kete magazinim apo perdorim te tyre. Betoni do te jete i parapergatitur nga subjekte te licencuara dhe perdorimi i tij do te jete drejteperdrejte ne veper.

Gjate fazes se funksionimit te instalimit

Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve me mbetje organike apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem; Sistemi i transportimit dhe ngarkim-shkarkimit do te jete i mbyllur dhe mundesite e shkarkimeve ne mjedis te mbetjes organike gjate procesit nuk egzistojne. Sistemi i terminalit te shkarkimit do te jete i shtruar me beton dhe si rrjedhoje nuk do te kemi ndotje te tokes, ne raste te derdhjes se lendes ne mjedis. Minimizimi i ndikimit ne mjedis do te lidhet ngushte me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron menaxhimin e mbetjeve, te shkaktoje shkarkim te tyre ne toke. Automjetet dhe makinerite do te jene te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Automjeteve do tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbaruatur papasterti te lendeve qe transportojne.

Shkarkimi ne toke i elementeve te demshem per mjedisin, shkakton ndotje serioze ne mjedis, ndaj rekomandohet qe aktiviteti gjate fazes operationale te jete i pajisur me masa mbrojtese dhe te jene te shtruara siperfaqet ku do te veprohet.

- **Ndotja e ajrit**

Gjate fazes se ndertimit te objektit:

Ne kete faze do te kemi gjenerim te grimcave te pluhurit si rezultat i proceseve te germimit dhe sistemimit te sheshit ne zhvillim, ndikim i cili do te zgjase 15 dite, nga momenti i fillimit te punimeve, deri ne momentin e hedhjes se betonit ne veper.

Gjate fazes se funksionimit te instalimit

Ndotja e ajrit do te vije si rezultat i gjenerimit te aromave te pakendshme dhe çlirimit te karbonit dhe gazit metan qe do te çlirohet gjate aktivitetit te rritjes se shpendeve.

Procesi punes se instalimit nuk do te perfshije procese te perdorimit te lendes djegese. Persa i perkete zhurmave, ato do te jene te ndjeshme vetem ne afersi te linjes se ventilatoreve deri ne nje distance prej 3-4 m dhe nuk do te jene problem per mjediset e brendshme apo te jashtme.

- **Mbetjet e ngurta**

Gjate fazes se ndertimit te objektit

Mbetje qe do te gjenerohen gjate fazes se ndertimit te objektit jane ato inerte dhe masa te dheut qe do te gjenerohen nga procesi i germimit, te cilat do te riperdoren per sistemimin e zones perreth objekteve dhe ndertimin e rruges komunikuese te objektit me rrugen rurale te zones.

Gjate fazes se funksionimit te instalimit

Mbetjet e ngurta do te vijne nga: Aktiviteti human, mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones.

Mbetjet organike qe do te gjenerohen gjate procesit te rritjes se shpendeve jane ne sasi te vogla dhe do te grumbullohen dhe rikuperohen nga subjekte te licencuara me qellim trajtimin dhe riperdorimin e tyre per rritjen e kulturave te ndryshme bujqesore.

- Përmbledhje e ndikimeve të mundshme negative në objektin ku do të instalohet impianti i rritjen e shpendeve

- Në Tokë

| | <i>Ndikimi i mundshëm</i> | <i>Sqarim</i> |
|---|--|---|
| 1 | Shkarkimi në mënyrë të pakontrolluar dhe mbingopja e sheshit të depozitimit të mbetjeve organike | Bëhet fjalë për ndonjë rast të rrallë të rrjedhjes gjatë difekteve dhe keqmenaxhimit nga punonjëset e shoqërisë |

- Në Ajër

| | <i>Ndikimi i mundshëm</i> | <i>Sqarim</i> |
|---|--|---|
| 1 | Gjenerimi i aromave dhe gazeve nga instalimi | Aromat dhe gazrat në nivele të ulëta janë të pranishme gjatë gjithë fazës së ushtrimit të aktivitetit për rritjen e shpendeve |
| 2 | Emetimi i zhurmave nga ventilatorët e ajrit | Zhurmat nga ventilatorët mund të shkaktohen vetëm në rast të defekteve, pasi vete tipi i ventilatorit është i tillë që të jetë sa më silensioz pasi ndikon në rritjen e stresit tek shpendet duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e shëndetshme të tyre |

Vlerësimi i rëndësisë të ndikimeve në mjedis të aktiviteti të rritjes së shpendeve

| <i>Receptori ndikimit</i> | <i>Shtrirje fizike madhësi a</i> | <i>Kohëzgjatja</i> | <i>Kthyeshmëria</i> | <i>Rëndësia si shumatorë e shtrirjes, kohëzgjatja dhe kthyeshmëria</i> | <i>Nevojat për masat zbutëse</i> |
|--|----------------------------------|--|---------------------|--|--|
| TOKA | | | | | |
| Shfrytëzimi i ambientit/territorit | Lokale | Përhershëm (objekt ekzistues) | Po | I pa rëndësishëm | mirëmbajtja e godinës, instalimit dhe territorit përreth |
| Ndikim në gjenerimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve organike | Lokale | Gjatë gjithë periudhës së rritjes së shpendeve | Po | I rëndësishëm | Vendosja e kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve sipas fraksioneve kryesore dhe grumbullimi, trajtimi dhe riperdorimi i mbetjeve organike nga |

| | | | | | |
|--|--------|--------------------------------------|----|------------------|---|
| | | | | | subjekte te licencuara |
| BIODIVERSITETI | | | | | |
| Shqetësim i faunës së zonës | Lokale | Përkoshëm | Po | I pa rëndësishëm | Është zonë e varfer me gjallesa |
| Ujrat | | | | | |
| Shkarkimi i ujrave teknologjik | Lokale | Përkoshëm | Po | I pa rëndësishëm | Shkarkimi i ujrave do të bëhet në një vaske dekantimi dhe me pas ne rrjetin e kanalizime të zones |
| AJER | | | | | |
| Shkarkimi i gazrave/aromave nga instalimi dhe nga motorrat që punojnë me GLN | Lokale | Gjate gjithë periudhës së instalimit | Po | I pa rëndësishëm | Kapja e gazrave me ane të filtrave dhe ajrosja herepashershme e lokaleve. Kolaudimi dhe kontrolli i çlirimit të gazrave në skapamentot e makinerive |

• **Permbeldhje e ndikimeve negative ne mjedis**

| Sektori | Presionet mjedisore | Ndikimet | Llojet | Pershkrimi / masat lehtesuese |
|----------------------------|---|---|--|---|
| Cilesia e Ajrit | Emetimi i garave dhe aromave ne atmosfere | Vlerat e pritshme jane te ulta krahasuar me normen e cilesise se ajrit. | Rajonal E perhershme E prapsueshme | Perqendrimi i ulet rekomandohen perdorimi i filtrave dhe ajrosje e lokaleve |
| Toka dhe ujrat nentokesore | Prania e ndotesve te mundshem ne toke dhe ujerat nentokesore. | Ambjenti do te jete i sistemuar dhe i shtruar me beton, i gjithë sheshi i shtruar | Lokale | Te gjitha zonat e magazinimit duhet te jene te shtruara dhe pajisur me sistem |

| | | | | |
|--|---|---|--|---|
| | | me beton do te jete i pajisur me rrjetin e drenazhimit i cili perfundon ne vasken e dekantimit | | kanalizimesh. Mundesia e ndotjes se tokes dhe ujerave nentokesore nuk ekziston. |
| Shkarkimi i Ujrave te perdorura | Ndotja e ujrave sipërfaqesore si rrjedhoje e shkarkimeve te ujerave te aktivitetit te instalimit. | Ndotje e ujerave sipërfaqesore pritesë, nga shkarkimet e ujerave te shiut ose larjes se ambjenteve te linjes se rritjes se shpendeve. Uji eshte menduar te kaloje me pare ne nje vaske dekantimi qe sherben edhe si kolektor kryesor i sheshit. | Lokale | Mirembajtja dhe pastrimi i sistemit te kanalizimeve te ujerave te ambjentit. |
| Zhurma | Emetimi i zhurmave nga procesi i punes. | Funksionimi do te kete ndikime vetem ne ambientin e punes, por nuk eshte shqetesim per objektet e tjera fqinje, megjithese kufizohet edhe me hapesira te lira. | Lokale E perhershme E prapsueshme | Nuk rekomandohen sepse vleresohen ne nivele te lejueshme. |
| Zonat Natyrore dhe te Ndjeshme | Ndikimi mbi habitatet e ndjeshme nga emetimet ne ajer. | Perqendrimet ne ajer e ndotesve do te jene ne perputhje me kufijte e percaktuar nga Direktiva e KE per mbrojtjen e mjedisit. | Rajonal E perhershme E prapsueshme | Menaxhimi i ujerave te perdorur dhe i mbetjeve te organike. |
| Peizazh | Modifikimi i karakteristikave peisazhore | Instalimi eshte brenda kapanonit qe do te ndertohet pikerisht per | Rajonal E prapsueshme | Rekomandohet mbjellje e pemeve te larta perreth objektit, ne menyre qe te |

| | | | | |
|-----------------------------|---|---|---|---|
| | | ketë qëllim | | reduktohet impakti në mjedis për shkak të demtitimit të peizazhit. |
| Trafiku | Rritja e trafikut rrugor | Furnizimi me lende të pare dhe shitja e produktit nuk ndikon në rritjen e trafikut rrugor. | Lokale E perhershme E prapsueshme | Do të hapen rruge të reja. Infrastruktura është në përgjithësi e mire. |
| Social Ekonomik | Mundësi të reja punësimi | Gjate funksionimit të instalimit do të jënë të punësuar 6-10 punonjës. Fuqia punëtore shtese do të përbëhet nga aktivitete të tjera detyesore si transporti, eksporti, etj. | Rajonal E perhershme E prapsueshme | Një vlerësim specifik mbi ndikimin social është planifikuar të kryhet për të vlerësuar me detaje ndikimet pozitive dhe negative të impianit mbi popullsinë vendase. |
| Shëndeti Publik | Ndikime në cilësinë e ajrit Zhurma e shkaktuar nga aktiviteti | Përqendrimet e ndotësve të emetuar do të jënë shumë të vogla dhe do të jënë në përputhje me gjendjen aktuale të cilësisë së ajrit. Nuk parashikohet ndikim në shëndetin e njerezve. | Rajonal E perhershme E paprapsueshme | Një vlerësim specifik mbi ndikimin social është planifikuar të kryhet për të vlerësuar me detaje ndikimet pozitive dhe negative të instalimit mbi popullsinë vendase. Ndikimet vlerësohen pozitive në lidhje me zhvillimin e zones. |
| Ndikime të tjera | Ndikime në mjedisin natyror dhe shëndetësor. | Nepërmjet procesit të rritjes se shpendeve me qëllim tregtimin e tyre drejt konsumatorëve final | Rajonal E perhershme | Subjekti të ushtroje aktivitetin brenda normave shqiptare të miratuar, duke u mbeshtetur nga institucionet e mbrojtjes së |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | | mjedisit per efektin pozitiv ekonomik-sosocial qe mbart. |
|--|--|--|--|--|

| Analiza S.W.O.T | |
|--|---|
| Forcat | Dobesite |
| <ul style="list-style-type: none"> • Potencial per zhvillimin ekonomik ne rang rajonal • Rritje e punesimit ne nivel lokal • Afersia e tij me zonat kryesore te vendit, industriale, tregtare dhe te transportit. • Afersia me lenden e pare per rritjen e shpendeve • Kapaciteti prodhues per plotesimin e nevojave te tregut brenda dhe jashte vendit. • Ndodhet ne zone periferike nga qyteti. • Proces teknologjik bashkekohor dhe paqesor me mjedisin. | <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e politikave shtetore per perkrahjen e subjektit per zgjerimin e prodhimit dhe te rritjes se punesimit, duke ndikuar ne lobimin e aktivitetete te tilla ne shtete te tjera. • Evazioni fiskal ne konkurrencen e pa ndershme nga kompani te ndryshme. |
| Mundesite | Kercenime |
| <ul style="list-style-type: none"> • Mundesi perfitimi ekonomike nga prodhimi, shitja dhe eksportimi i produktit. • Mundesi punesimi dhe zgjerimi te aktivitetit. • Ofrimi i produkteve cilesore, me cmime te konkureshem ne tregun vendas e te huaj. • Maksimizimi i perdorimit te lendes se pare • Trajtimi i sigurte te mbetjeve qe gjenerohen brenda instalimit | <ul style="list-style-type: none"> • Konkurenca e pa ndershme dhe mos respektimi i detyrimeve dhe percaktimeve ligjore nga subjektet prodhues. • Faktore te tille si remonti i instalimit dhe dentimi i cilesise se ajrit. • Dukurite natyrore, kryesisht nga termetet dhe permbytjet. |

Parandalimi i aksidenteve dhe reagimet gjatë emergjencave.

Subjekti "Hymar Group" sh.p.k. do te nënkontraktoj specialistë të ndryshëm të fushës për hartimin e një plani, për funksionimin dhe operimin normal të punës në objektin ku do te instalohen linjat e rritjes se shpendeve. Ky plan konsiston në menaxhimin e situatave emergjente që mund të dalin operimit të linjës së instaluar. Synimi i subjektit është mbrojtja e mjedisit, habitateve natyrore të zonës, sigurimi i jëtës së punonjësve, duke krijuar një infrastrukturë dhe kushtet e përshtatshme optimale gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij. Grupi i ekspertëve ka hartuar dhe improvizuar raste të ndryshme të avarive dhe emergjencave që mund të ndodhin në objektin dhe linjat e instaluara, masat që do të ndërmerren dhe grupin

përgjegjës të punës për restaurimin dhe rigjenerimin e zonës që mund të jetë objekt i këtyre ndikimeve.

Stimulimi i situatave të ndryshme dhe masa që do të ndërmerren gjatë funksionimit të instalimit për rritjen e shpendeve, janë përshkruar në tabelën e mëposhtme:

| Situatat e Stimuluara | Ndikimi mundshëm në mjedis | Masat që do të ndërmerren | Personi përgjegjës | Periudha e ndërhyrjes dhe zgjidhjes së situatës |
|------------------------------------|---|---|--------------------|--|
| Epidemite e ndryshme | <ul style="list-style-type: none"> - Ndotja e indikatorëve të mjedisit Ajër, Tokë dhe Ujë - Shfaqje e semundjeve të ndryshme në lekuren e punonjësve - Rritja e numrit të banorëve të infektuar nga epidemia | <ul style="list-style-type: none"> - Njoftimi i menjehershëm i ISHP-së për situatën e krijuar - Ndalimi i menjehershëm i proceseve të punës që zhvillohen - Asgjësimi i menjehershëm i mbetjeve që janë gjeneruar në mënyrë sa më të sigurtë dhe sa më të kontrolluar - Izolimi i punonjësve deri në zgjidhjen e situatës dhe konstatimin e burimit të kësaj epidemie - Dezinfektimi i të gjitha ambienteve të kompanisë - Asgjësimi i menjehershëm i veshjeve të punonjësve - Trajtimi i gjithë të prekurve me medikamente deri në sigurimin e plotë të jetës së tyre | Subjekti | <ul style="list-style-type: none"> - Nderhyrja do të jetë e menjehershme |
| Avare teknike të instalimit | <ul style="list-style-type: none"> - Dëmtimi i pajisjeve/instalimeve | <ul style="list-style-type: none"> - Ndërprerja e aktivitetit - Njoftimi i | Punonjësit | <ul style="list-style-type: none"> - Nderhyrja duhet të bëhet brenda 30 min |

| | | | | |
|------------------------|--|--|---|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Rrjedhje të lubrifikantëve nga mjetet e transportit, ngarkim-shkarkimit etj - Bllokim i linjes së rritjes së shpendeve | <p>Menaxherit të prodhimit për situatën</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kapja, Pastrimi dhe Asgjësimi i rrjedhjeve të mundshme të lubrifikantëve - Riparimi i menjëhershëm i defekteve teknike - Zëvendësimi i pjesëve të prishura/demtuara me të reja - Kolaudimi i pajisjeve dhe mjeteve pas riparimit, duke u siguruar për operimin normal të tyre | | <p>nga momenti i njoftimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punimet për zgjidhjen e avarive teknike duhet të zgjidhen brenda 4 ditëve pune, në rast të kundërt duhet të bëhet zëvendësimi i paisjes ose mjetit me një tjetër deri në riparimin e tij/saj të plotë, për operimin normal të punës. |
| Rënia e zjarrit | <ul style="list-style-type: none"> - Dëmtimi i bimësisë së zonës - Rrezikimi i jetës së punonjësve - Dëmtimi i mjeteve dhe instalime që ndodhen në objekt - Ndotja e ajrit - Rrezik për përhapjen e epidemive | <ul style="list-style-type: none"> - Ndërprerja e menjëhershme e punës - Lokalizimi i vendodhjes ku ka rënë zjarri - Njoftimi i PMZZH dhe Njësisë Vendore - Evakuimi i punonjësve dhe faunës së zonës ku ka rënë zjarri - Paisja e punonjësve me veshje kundër zjarrit - Mobilizimi i punonjësve për shuarjen e zjarrit me Hidrante, shkurre, ujë, rërë - Rrethimi i zonës ku ka rënë zjarr duke e minimizuar përhapjen e tij, në zonën përreth dhe | <p>Punonjësit Administratori i Subjekti PMNZSH Njësia Vendore</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Ndërhyrja duhet të jetë e menjëhershme deri në shuarjen përfundimtare të zjarrit dhe sigurimit që ska më të ngjarë |

| | | | | |
|-----------------------------|------------------------|--|---|---|
| | | zonat fqinje. - Shuarja e zjarrit dhe sigurimi që nuk ka vatra të tjera aktive | | |
| Aksidentet njerëzore | - Dëmtimi i punonjësve | - Në rast aksidenti, ndihma e parë do ti jepet nga kolegu i punës - Me të ndodhur aksidenti, njoftohen punonjësit e tjerë për situatë e krijuar. - Të aksidentuarit i jepet ndihma e parë me anë të kutisë së ndihmes se shpejtë e cila ndodhet në cdo repart të pularise dhe në zyrat e shoqërisë. - Njoftohet menjëherë qendra spitalore më e afërtë me anë të telefonit. - Nëse gjendja është e rëndë transporti do të bëhet me mjetin e kompanisë që është në dispozicion për përballimin e situatave emergjente | Punonjësit Menaxheri i Prodhimit Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë Qendra Spitalore | - Dhënia e ndihmës së shpejtë do të jetë e menjëhershme |

Për menaxhimin sa më të suksesshëm të aksidenteve dhe situatave emergjente, stafi i punonjësve të që do te operojnë në objektin për rritjen dhe therjen e shpendeve, do te jene të trajnuar për përballimin e situatave të tilla. Çdo fillim muaji nën kujdesin e Menaxherit te Prodhimit të shoqërisë, do te improvizohen skema të ndryshme për përballimin e situatave të tilla, duke rritur performancën e punonjësve dhe sigurimit të punës.

4. PËRSHKRIMI I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Gjate fazes së funksionimit të instalimit do të kemi shkarkime të gazrave dhe aromave që do të gjenerohen nga instalimet e shpendeve, të cilat duhet të jenë brenda normave të lejuara referuar VKM 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimit në ajër në Republikën e Shqipërisë" në instalimet për rritjen e shpendëve aplikohen normat e mëposhtme:

Strukturat dhe linjat për mbarështimin e kafshëve shtëpiake dhe shpendeve

- Komplekset me zënie mesatare vjetore mbi 500 kokë gjedhë, mbi 5000 kokë derra dhe mbi 50 000 kokë shpendë duhet të konsiderohen burime të mëdha ndotje.

- Komplekset me zënie mesatare vjetore ndërmjet 180 dhe 499 kokë gjedhë, 500-4999 kokë derra dhe mbi 1000-49 999 kokë shpendë duhet të konsiderohen burime mesatare ndotje.

Vlerat e përgjithshme të normave të shkarkimit janë njëlloj të vlefshme për tu zbatuar për amonjakun. Substancat me erë nuk duhet të përmbahen në ajrin e shkarkuar në përqëndrime që do të përbënin shqetësime për banorët. Shkarkimet e substancave organike të shprehura në karbon total nuk duhet të kalojnë vlerat e mëposhtme:

- a) jashtëqitje në të ngrohtë për prurje më të mëdha se 50 gram/orë 50 mg/m^3
- b) jashtëqitje në të ftohtë për prurje 50-300 gram/orë 120 mg/m^3
- c) jashtëqitje në të ftohtë për prurje më të mëdha se 300 gram/orë 50 mg/m^3

Gjate fazes së funksionimit të instalimit do të kemi shkarkime të ujerave të përdorura që do të gjenerohen nga instalimet e shpendeve, të cilat duhet të jenë brenda normave të lejuara referuar VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"

Depozitimi i plehut të shpendeve, do të grumbullohet dhe depozitohet perkohesisht në territorin e vizuar, sipas hartës bashkangjitur. Me pas do të transportohet dhe trajtohet nga subjekte të licencuara. Ambienti i depozitimit të plehut organik me prejardhje nga shpendet, do të jetë i shtruar me beton dhe i pajisur me rrjetin e drenazhimit të ujrave, i cili do të perfundojë në vasken e dekantimit.

Tipet e mbetjeve gjë do të gjenerohen nga instalimi për rritjen e shpendeve gjate fazes së funksionimit do të jenë:

02 01 01 - Llumra që vijnë nga larja dhe pastrimi

02 01 06 - Fekale, urinë dhe pleh (duke futur këtu dhe pleh kashtë të prishur), rrjedhje, mbeturina të ndara dhe të trajtuara jashtë qendrës së trajtimit

02 01 09 - Mbetje bujqësore, përveç atyre të paraqitura në rubrikën 020108

02 01 10 - Mbetje të tjera të paspecifikuara

20 01 01 - Letër dhe karton

20 01 02 - Qelq

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi në mjedis gjate fazes së ndertimit kanë mabruar sepse subjekti e ka perfunduar ndertimin me kohë nga data e miratimit të Lejes së Ndertimit, ndërsa gjate fazes së funksionimit ndikimi në mjedis do të jetë i pranishëm gjate gjithë fazes së ushtrimit të aktivitetit për rritjen intensive të shpendeve.

6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe gjate fazes se funksionimit te instalimit per rritjen e shpendeve, nuk do te kete shtrirje te gjere fizike ne zonen qe zhvillohet. Ndikimet e mundshme ne mjedis do te jene te pranishme ne nje distance rreth 300-500m kryesisht nga aromat e plehut organik.

7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mbrojtjen e mjedisit. Keshtu subjekti ka detyrimin qe te zbatoje kushte te larta higjienike, sigurie fizike dhe ndaj renies se zjarreve ne objekt. Mjedisit perreth objektit te ruhet i paster dhe i kendshem, te mos kontaminohet me materiale te tilla si lenda e pare apo mbetje te ndryshme te mundshme.

8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

MASAT ZBUTESE TE PROJEKTUARA TE NDIKIMEVE NEGATIVE GJATE PROÇESIT TE FUNKSIONIMIT

Masat zbutëse të ndikimeve negative do te konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë rritjes se shpendeve si në ajër, si gazrat/aromat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore në territor , faune dhe florë. Por pikësynimi i studimit mbetet menaxhimi i linjës së rritjes se shpendeve dhe evitimi në maksimum i çlirimit te gazrave dhe aromave ne ajer dhe ujrave teknologjik.

Identifikimi i masave për të eliminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

- Planifikimi i zones së instalimit

Për shmangien dhe parandalimin e gjenerimit të grimcave te gazrave/aromave dhe zhurmave, si dhe për ruajtjen e regjimit të linjës së dhe prametrave inxhinieriko - mekanike të saj, në projekt do te përcaktohet funksionimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë i objektit në tërësi dhe i instalimit per rritjen dhe therjen e shpendeve.

Në objektin ku ndodhet instalimi do te parashikohet hapa pas hapi, rigjenerimi i mjedisit të brendshëm e të jashtëm, sistemimi i lëndës së pare, parkimi i automjeteve, magazinimi i pajisjeve/makinerive ndihmese dhe ngarkimi produktit të prodhuar duke realizuar shfrytëzimin sa më eficient të mjedisit të shfrytëzuar nga subjekti.

Pergjate perimetrit te zones ku do te instalohet impianti i rritjes dhe therjes se shpendeve duhet te mbillen kurore pemesh te gjelberta te reja me lartesi 3-4m dhe me distance nga njera tjetra. Kjo sipërfaqe e përfutur nga trajtimet e mësipërme, do te jape mundësi për rikultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për parandalimin e emetimit të grimcave të pluhurit, kapjen e ndotesve atmosferik dhe përmisimin e pamjes së përgjithshme të mjedisit të zonës në shfrytëzim.

MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV

| <i>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</i> | |
|--|--|
| Toka | |
| Përdorimi i Tokës | Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në |

| | |
|---|---|
| | relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve. |
| Erozioni | |
| Mbrojtja nga erozioni | Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së rritjes dhe therjes së shpendeve. Pastrimi periodike i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. |
| Biodiversiteti | |
| Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit | Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjatë rrugës që ben të mundur hyrjen për në objekt. |
| Cilësia e ajrit | |
| Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i instalimit të shpendeve dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit | Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së instalimit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij. |
| Sistemi i kullimit | |
| Sistemi i kullimit | Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike të pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët, ku më pas do të realizohet shkarkimi në kolektorin kryesor të kanalizimeve të zonës |
| Mbetjet | |
| Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt dhe mbetjeve organike të gjeneruara nga shpendet | Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësi vendore. Grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve që vijnë nga instalimi, nga kompani të licensuara. |
| Ujërat e Ndotura Urbane | Trajtimi i ujrave të përdorura teknologjike, duke i deguar në vasken e dekantimit dhe me pas shkarkimi i tyre në kolektorin kryesor të zonës. Lidhja me sistemin e kanalizimeve të zonës. Minimizimi i konsumit të ujit. |
| Zhurmat | |
| Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve dhe nga përdorimi i ventilatoreve | Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjatë orëve të përshtatshme. Mirëmbajtja e sistemit të ventilimit |
| Trafiku rrugor | |
| Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit | Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin |

| | |
|-------------|---|
| automjeteve | brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor. |
|-------------|---|

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të tjera
- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambient të mbyllur kështu që nuk do ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth.
- Ndertesa ku do të zhvillojë aktivitetin subjekti do të jetë lidhur me rrjetin e kanalizimeve të zonës. Subjekti ka parashikuar ndertimin e sistemit të grumbullimit të rrjedhjeve dhe ujërave sipërfaqësor dhe devijimit të tyre në vasken e dekantimit dhe me pas në rrjetin e kanalizimeve.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Nuk do të kemi gjenerimin e Mbetjeve të rrezikshme.
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazan të veçantë. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore për mbetjet urbane. Mbetjet e paketimit do të mblidhen dhe dorëzohen në kompani të licensuar për përdorimin, riciklimin apo trajtimin e tyre.
- Mbetjet organike do të grumbullohen dhe trajtohen nga subjekte të licencuara
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

MASAT LEHTESUESE.

Subjekti do të investojë për implementimin e makinerive dhe teknologjive të reja duke pasur qëllim uljen e koeficientit të mbetjeve dhe shfrytëzim në maksimum të lendës së parë, automatizimin e veprimeve dhe uljen e gabimeve njëzore, reduktimin e pluhurave/gazrave dhe aromave në atmosferë, si dhe uljen e impaktit të zhurmave dhe vibrimeve në ambientet e punës.

Cilesia e ajrit.: për përmirësimin e cilësive së ajrit në ambientet e punës Subjekti do të investojë në kapjen e aromave dhe gazrave të gjeneruara nga instalimi nepermjet filtrave që do të vendosen tek ventilatoret të cilët do të bëjnë qarkullim të ajrit, duke furnizuar instalimin me ajër të pastër.

Punonjësit do të jenë të pajisur me maska me fibra karboni.

Zhurmat: për eliminimin e zhurmave subjekti do të investojë në një sërë masash e përsosje. Punonjësit do të jenë të pajisur me tapa veshesh për të shmangur nivelin e lartë të zhurmave në organet shqisore dhe do të jenë të pajisur me veshje të tilla për të mbrojtur njëkohësisht edhe nga pluhurat dentimet e syve, veshëve, etj, nepermjet maskave të posaçshme. Zhurmat që do të gjenerohen nga instalimi do të jenë shumë të vogla pasi dhe vete lloji i instalimit për rritjen e shpendeve nuk e lejon gjenerimin e zhurmave tej normave të rekomanduara.

Komuniteti lokal dhe aspektet social-ekonomike: shoqëria për nevojat e aktivitetit të saj do të plotësojë të gjitha kushtet për sa i përket ujit të pijshëm, ujit sanitar dhe për përdorim me të gjere si për ujë, larje të ambienteve, etj. Për këto nevoja shoqëria do të përdorë ujë nga rrjeti i ujësjes së zonës dhe një pusi të hapur që fillimet e saj. Në këtë mënyrë shoqëria nuk do të ndikojë plotësisht në rrjetin e zonës. Për sa i përket energjisë elektrike subjekti do të

perdor energjine qe vjen nga rrjeti, gjithashtu ka perlllogaritur dhe blerjen e nje gjeneratori ne rast te avarive te ndryshme, per perballimin e nevojave te vete iinstalimit dhe godines.

Masa lehtesuese te tjera te kerkuara

Do te mundesohet nje menaxhim sa me me eficient te energjise elektrike. Impiantet e nevojshme do te jene projektuar ne perputhje me Ligjin e ri, nr.9379, date 28-04-2005 "Per Eficencen Energjise"i ndryshuar, kjo do te çoj ne uljen e ndotjeve termike te mikroklimes se zones si dhe kursim te energjise elektrike nga perdorimi i impianteve me eficence.

Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese. Do te instalohet sistemi i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato do te kene) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor, gjithashtu dhe krijimi i kanaleve te kullimit ne kapanon ku ujerat e tyre do te mblidhen ne vasken e dekantimit dhe pastaj do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones aty prane prones por jo te ndotur me lende te tjera.

Do te kryhet nje menaxhim i mbetjeve te ngurta, te cilat do te jene; lende te amballazheve, letra-kartona, si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit dhe instalimi ku keto mbetje do te depozitohen ne vendin e caktuar nga Njesia Vendore dhe Drejtuesi Teknik i shoqerise, do te vendosen kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen, do te depozitohen ne koshat e vendosur brenda objektit ku zhvillohet veprimtaria dhe me pas do te transportohen periodikisht ne konteneret te percaktuar nga Njesia Vendore, ku do te jete nje sasi prej 0.4kg/dite per person. Mbetjet organike do te grumbullohen dhe trajtohen me qellim perdorimin e tyre ne kultura te ndryshme bujqesore. Do te realizohet tokezimi i rrjetit elektrik per te shmangur ndonje shkarkese elektrike, konform kushteve teknike.

9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR.

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

Studio ADDON
Ing. Yzeir MIRAHA
Ing. Lila KARAJ
Kimiste ushqimore Donalda MIRAHA

